AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), 2022

31.08.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për 2022.

Shkalla e papunësisë në Kosovë 12.6%

Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 195 426) janë popullsi në moshë pune (36 269 më pak se në vitin paraprak).
Persona aktiv ishin 21 571 më pak se në vitin paraprak.
Persona joaktiv ishin 14 698 më pak se në vitin paraprak.
Persona të punësuar ishin 20 509 më shumë se në vitin paraprak.
Persona të papunësuar ishin 42 080 më pak se në vitin paraprak.

Indikatorët kryesorë të Tregut të Punës 2022 / 2021

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (NË MIJËRA)	2022			2021		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktivë) (15-64 vjeç)	329 469	132 425	461 894	347 605	135 860	483 465
Persona joaktivë (15-64 vjeç)	264 056	469 476	733 532	266 013	482 217	748 230
Të punësuar (15-64 vjeç)	293 285	110 528	403 813	281 451	101 853	383 304
Të papunësuar (15-64 vjeç)	36 184	21 897	58 081	66 154	34 007	100 161
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	7 338	5 204	12 542	15 868	11 000	26 868
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)	49 665	49 040	98 705	53 851	51 281	105 132
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	46 145	7 640	53 785	41 837	6 920	48 757
Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	55.5	22.0	38.6	56.6	22.0	39.3
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	44.5	78.0	61.4	43.4	78.0	60.7
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	49.4	18.4	33.8	45.9	16.5	31.1
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	11.0	16.5	12.6	19.0	25.0	20.7
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	18.6	27.0	21.4	33.7	46.5	38.0
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	32.2	33.8	33.0	31.8	32.4	32.1
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	15.7	6.9	13.3	14.9	6.8	12.7

Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 3,5% më e lartë sesa në vitin paraprak. Kurse, përqindja e femrave të punësuara ishte 1,9% më e lartë se në vitin paraprak.

Shkalla e punësimit ishte 2,7% më e lartë sesa në se në vitin paraprak.

Shkalla e papunësisë ishte më e ulët për (- 8,1%) sesa në vitin paraprak.
Kurse tek të rinjtë (15-24 vjeç), shkalla e papunësisë ishte më e ulët për (-16,6%) sesa në vitin paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë (61,4 %), duke u rritur për 0,7%, krahasuar me vitin paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit tek femrat ishte shumë e theksuar me 78,0 %, krahasuar me meshkujt, 44,5 %.

Tregtia, ndërtimtaria dhe arsimi prijnë me punësim

Sektorët ekonomikë, që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 19,3%, ndërtimtaria 11,0%, arsimi me 10,8%, prodhimi me 8,9%, administrata publike dhe mbrojtja me 8,1%, etj.

Femrat ishin të punësuara, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, me 55,6% të tyre. Ndërsa, meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë, prodhimit, aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi dhe administratë publike dhe mbrojta, me 60,6%.

Të punësuarit sipas gjinisë dhe aktiviteteve ekonomike në vitin 2022, mosha 15+

Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	2.7	0.9	2.2
B - Minierat dhe xehroret	1.1	0.5	0.9
C - Prodhimi	10.1	5.7	8.9
D - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	3.4	0.4	2.6
E - Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.2	0.3	0.9
F - Ndërtimtari	14.6	1.6	11.0
G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	19.5	19.0	19.3
I - Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	8.3	6.2	7.7
H - Transport dhe depozitim	5.6	1.4	4.4
J - Informim dhe komunikim	2.4	2.7	2.5
K - Aktivitete financiare dhe sigurimesh	2.7	2.3	2.6
L - Aktivitete me prona të paluajtshme	0.3	0.1	0.2
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.4	2.6	2.4
N - Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.6	4.8	3.9
O - Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	8.1	8.3	8.1
P - Arsimi	6.6	22.0	10.8
Q - Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	3.1	14.6	6.3
R - Arti, zbavitja dhe rekreacioni	1.0	0.7	0.9
S - Aktivitete të shërbimeve të tjera	2.3	4.4	2.9
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	0.2	0.4	0.2
U - Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.9	1.1	1.0
Gjithsej	**100.0**	**100.0**	**100.0**

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Ky publikim ofron të dhëna statistikore për treguesit e tregut të punës bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP). Për realizimin e AFP-së, 2022, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për 2022 vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/LaborMarket